

djali i Tahirit, Rexhepi, e ka organizuar zhvarrimin e varrezës ku thuhej se prehej i ati. E kishte identifikuar atë në bazë të rrobave të tij të trupit. Po atë ditë, Tahiri u rivarros në varrezat e Drenocit/Drenovac.

Më vonë, familja ka mësuar nga Idriz Balaj, i cili ishte një nga komandantët e UÇK-së në rajon, se Tahiri ka pësuar nga goditja e predhës minahedhëse gjatë sulmeve të forcave serbe, të kryera ndaj **Drenocit/Drenovac** më **14.06.1998**. Predha kishte rënë afro 200 metra larg shtëpisë së Tahirit dhe me këtë rast u vrënë, po ashtu, edhe Armend Kukleci dhe Blerim Lokaj. Forcat serbe i kishin marrë me vete trupat e tyre dhe i kanë varrosur në varrezat e qytetit të Pejës/Peç.

**Burimet:** deklarata R.A, FDH-18697; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Armend (Tafil) Kukleci

(1.10.1975, shqiptar nga Peja/Peç, student, pjesëtar i UÇK-së)

Armendi ishte student i anglishtes në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës/Priština. Aderoi në radhët e UÇK-së më 25.04.1998. Përgatitjet ushtarake i ka kryer në Glllogjan/Glođane. Pastaj u sistemua në Njësitin Special të UÇK-së për Reagime të Shpejta *Shqiponjat e zeza/Crni orlovi*. Bashkëluftëtarët e thërrisnin *Pejan*. Armen-di ka rënë gjatë sulmit të forcave serbe në **Drenoc/Drenovac**, më **14.06.1998**. Trupi i tij u zbulua pas lufte në varrezat e qytetit të Pejës/Peç. Armendi u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Glllogjan/Glođane, më 24.08.1999.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

### Blerim (Selman) Lokaj

(14.12.1975, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, student, pjesëtar i UÇK-së)

Blerimi ka qenë student i Fakultetit për Kulturë Fizike pranë Universitetit të Prishtinës/Priština. Në datën 23.04.1998, ai me vëllain Gazmendin aderuan në radhët e UÇK-së. Ishte pjesëtar i njësitit

special *Shqiponjat e zeza/Crni Orlovi*. Blerimi pësoi gjatë sulmit të forcave serbe më **14.06.1998**, vetëm tetë ditë pas vrasjes së vëllait Gazmendit [të shikohet regjistrimi], në **Drenoc/Drenovac**. Trupin e tij, forcat serbe e kishin marrë me vete në Pejë/Peç dhe e kanë varrosur në varrezat e atjeshme. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Blerimit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Prilep.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

### Saša (Milivoje) Jovanović

(9.10.1966, serb nga Beogradi, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Saša e ka mbaruar shkollën e mesme për punë të brendshme. Që nga viti 1990, ai ka punuar pranë Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të MPB-së së Serbisë. U vra gjatë përlëshjeve me pjesëtarët e UÇK-së në rajonin e fshatit **Drenoc/Drenovac**, më **14.06.1998**.

**Burimet:** KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 33; SMIP, *Terroristički...*, III, 933; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, 3, 118.

### Shaban (Ukë) Sejfiqaj

(5.05.1969, shqiptar nga Gramaçeli/Gramoçelj, komuna e Deçanit/Deçani, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Shabani e ka mbaruar Shkollën e Mesme Policore në Vushtrri/Vučitrn dhe ka punuar si oficer policie në Dragash/Dragaš. E ka ndërprerë punën më 1990, kur shqiptarët e braktisën shërbimin policor. Në datën 24.03.1998, Shabani aderoi në radhët e UÇK-së. I ka organizuar trajnimet për pjesëtarë të rinj të UÇK-së. U emërua komandant i njësitit për trajnime. Ka gjetur vdekjen kur forcat serbe e bombarduan **Gramaçelin/Gramoçelj** më **18.06.1998**.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

### Isa (Zymer) Tofaj

(9.09.1957, shqiptar nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)